



**FEDERATA E TENISIT E KOSOVËS  
TENISKA FEDERACIJA KOSOVA  
KOSOVO TENNIS FEDERATION**

Në bazë të nenit 10 të Statutit të Federatës së Tenisit të Kosovës të datës 24 nëntor 2018, Bordi i Federatës miraton këtë:

## **RREGULLORE #01**

**PËR**

**KËSHILLIN E REFERËVE TË TENISIT TË KOSOVËS**

**VERSIONI 1.0**



## PËRMBAJTJA

1. Përkufizimet.....	2
2. Themelimi dhe objektivat.....	2
3. Mbledhjet e Këshillit.....	3
4. Anëtarësia / Anëtarët.....	3
5. Komisioni Drejtues.....	4
6. Financimi.....	5
7. Dispozitat përfundimtare.....	5

## VERSIONET E DOKUMENTIT

Versioni	Në fuqi	Aprovoi / Data e aprovimit	Ndryshimet
1.0	01.01.2019	Bordi / 13.12.2018	-

## 1. Përkufizimet

<b>Administrata</b>	Administrata e Federatës me të cilën udhëheq Sekretari
<b>Anëtar</b>	Anëtar i Këshillit të Referëve të Tenisit të Kosovës me të drejtë vote.
<b>Bashkëpunëtor</b>	Bashkëpunëtor në Këshill, pa të drejtë vote.
<b>Bordi</b>	Bordi Ekzekutiv i Federatës
<b>Federata</b>	Federata e Tenisit e Kosovës
<b>Këshilli</b>	Këshilli i Referëve të Tenisit të Kosovës
<b>Komisioni</b>	Komisioni Drejtues i Këshillit të Referëve të Tenisit të Kosovës
<b>ITF</b>	Federata Ndërkombëtare e Tenisit
<b>Kryesuesi</b>	Kryesues i Komisionit Drejtues dhe Përfaqësues i Këshillit
<b>Refer i licencuar</b>	Refer i licencuar nga FTK, Tennis Europe dhe /ose ITF.
<b>Sekretari</b>	Sekretari i Përgjithshëm i Federatës

## 2. Themelimi dhe objektivat

- 2.1. Me aprovimin e kësaj rregulloreje Bordi i Federatës, në kuadër të këshillave dhe komisioneve të tij, themelon Këshillin e Referëve të Tenisit të Kosovës (me shkurtesë zyrtare KRTK), dhe rregullon veprimtarinë e saj.
- 2.2. Këshilli mbledh referët e tenisit për realizimin e detyrave dhe interesave të përbashkëta, dhe të veprimeve të përbashkëta në shërbim të referimit. Këshilli ka për qëllim dhe detyrë të:
  - inkurajojë dhe të promovojë sportin e tenisit nëpërmjet aktivitetit të referimit;
  - inkurajojë shtimin e numrit të referëve, në veçanti numrin e referëve femra;
  - delegojë referët në garat e tenisit në garat zyrtare të Federatës;
  - kujdeset për trajnimin dhe avancimin profesional të referëve;
  - ngrit kulturën, frymën dhe etikën sportive të Anëtarëve të saj;
  - nëpërmjet përfaqësuesve të saj, merr pjesë në punën e organeve të Federatës kur kjo i kërkohet nga Bordi apo Kuvendi.
- 2.3. Këshilli respekton rregulloret e Federatës dhe rregulloret e ITF që ndërlidhen me referimin.
- 2.4. Këshilli pushon së vepruari kur:
  - (a) Këtë e kërkojnë së paku gjysma e Anëtarëve; ose
  - (b) Shoqata e Referëve të Tenisit të Kosovës themelohet dhe anëtarësohet në Federatë në përputhje me Statutin e Federatës.

### 3. Mbledhjet e Këshillit

- 3.1. Mbledhjet e Këshillit i udhëheq Sekretari apo i deleguari i tij. Kuorumi arrihet kur janë prezent së paku 50% e Anëtarëve.
- 3.2. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë të votave të Anëtarëve prezent. Votimi bëhet i hapur, përpos kur zgjedhen anëtarët e Komisionit.
- 3.3. Mbledhja vjetore e Këshillit mbahet pas përfundimit të sezonit zyrtar të garave për atë vit. Mbledhjen e thërret Sekretari me paralajmërim prej së paku pesëmbëdhjetë (15) ditësh.
- 3.4. Mbledhjet e jashtëzakonshme duhet të thirren brenda tetë (8) ditësh nga kërkesa e Bordit, e Komisionit, apo e shumicës së Anëtarëve të Këshillit.

### 4. Anëtarësia / Anëtarët

- 4.1. Anëtarë të Këshillit janë të gjithë referët e tenisit nga Republika e Kosovës të cilët me vullnet të lirë, duke pranuar të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë të përcaktuara më këtë Rregullore, deponojnë kërkesë me shkrim tek Administrata.
- 4.2. Anëtarë mund të jenë vetëm personat e moshës tetëmbëdhjetë (18) vjeçare e sipër dhe të cilët janë referë të licencuar të tenisit.
- 4.3. Anëtari për të dalë nga Këshilli duhet dërguar kërkesën me shkrim si dhe të kryen të gjitha obligimet financiare që i ka ndaj Këshillit dhe Federatës.
- 4.4. Anëtari mund të përjashtohet nga Këshilli kur i thyen dispozitat e kësaj Rregulloreje ose aktet e tjera normative të Federatës, apo vepron në kundërshtim me interesat e Këshillit se të Federatës. Vendimin për përjashtim e bie Bordi.
- 4.5. Administrata ka për detyrë ta mirëmbajë listën e Anëtarëve në uebfaqen zyrtare të Federatës.
- 4.6. Detyrat dhe përgjegjësitë e Anëtarëve janë:
  - Pagesa e anëtarësisë në Federatë;
  - Shmangja e animit, sjelljes joprofesionale, dhe e konfliktit të interesit ku ai shfaqet;
  - Të kryejnë punën e mbikëqyrësit / referit në garat e tenisit kur janë të deleguar nga Këshilli. Pamundësinë për pjesëmarrje duhet raportuar me kohë.
  - Ndjekja e seminareve dhe e kurseve obligative për edukim të vazhdueshëm kur ato organizohen nga Këshilli apo Federata;
  - Mbatja e veshjes / uniformës, me logot e sponzorëve, siç caktohen nga Federata;

- 4.7. Bashkëpunëtorë të Këshillit, pa diskriminim, janë të gjithë personat e Republikës së Kosovës që nuk janë referë të licencuar të tenisit por të cilët duan të ndihmojnë në referim (p.sh. të vijave), dhe për këtë deponojnë kërkesë me shkrim tek Këshilli.
- 4.8. Bashkëpunëtorët nuk kanë të drejtë vote.
- 4.9. Bashkëpunëtorë mund të jenë vetëm personat e moshës dymbëdhjetë (12) vjeçare e sipër.
- 4.10. Komisioni ka për detyrë ta mirëmbajë listën e Bashkëpunëtorëve në regjistrat e Federatës.

## 5. Komisioni Drejtues

- 5.1. Këshilli nga radhët e Anëtarëve të saj përzgjedh Kryesuesin e Komisionit me mandat dy (2) vjeçar. Këshilli, me rekomandim të Kryesuesit të përzgjedhur, emëron edhe dy (2) anëtarë të tjerë të Komisionit. Përbërjen e Komisionit e ratifikon edhe Bordi.
- 5.2. Përbërja e Komisionit duhet të përfaqësojë diversitet rajonal, dhe sipas mundësive edhe gjinor.
- 5.3. Kryesuesi do ta përfaqësojë Këshillin në organet e Federatës, dhe njëherësh udhëheq me mbledhjet e Komisionit.
- 5.4. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë:
  - Në bazë të rotacionit, dhe pa diskriminim, cakton referët dhe mbikëqyrësit e turneve në kalendarin zyrtar të Federatës. Referët duhet caktuar së paku katër (4) javë para fillimit të turneut në bashkëpunim me ta;
  - Propozon në Bord plane për zhvillim, seminare dhe trajnim / avancim të referëve;
  - Propozon për miratim të Bordit çmimoren për angazhimin e Anëtarëve dhe Bashkëpunëtorëve;
  - Raporton në Bord për realizimin e planit të veprimit dhe të punës së referëve;
  - Inicion në Bord procedurë disiplinore për referë me performancë të ulët, neglizhim detyrash dhe / ose për sjellje të pahijshme;
  - Propozon Anëtarët për shpërblime dhe mirënjohje;
  - Asiston administratën në lidhje me raportimin apo publikim të çështjeve që ndërlidhen me punën e Këshillit;
  - Sipas nevojës, krijon komisione të tjera të punës që ndërlidhen me fushëveprimin e Këshillit.
- 5.5. Në realizimin e punëve të saj, Komisioni dhe Këshilli asistohen nga Sekretari dhe Administrata.

## 6. Financimi

- 6.1. Për realizimin e veprimtarisë së vet, krahas buxhetit të ndarë nga Federata (nëse ka), Këshilli mund të realizojë të hyra nga granet komunale apo donacionet dhe sponsorizimet e ndryshme të cilat nuk bien ndesh me ligjin, rregulloret e Federatës, apo sponsorët ekzistues të Federatës.
- 6.2. Këto të hyra duhet të arkëtohen vetëm nëpërmes xhironlogarisë bankare të Federatës. Pagesat duhet të administrohen nga Administrata dhe pëlqimi për shpenzimet të aprovet nga Kryetari i Federatës.

## 7. Dispozitat përfundimtare

- 7.1. Kjo Rregullore hyn në fuqi më 1 janar 2019.
- 7.2. Mbledhja e parë e Këshillit për ta zgjedhur Komisionin, por edhe për çështje të tjera nëse ka, duhet të mbahet brenda afatit prej 30 ditë nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje.
- 7.3. Interpretimi i kësaj Rregulloreje është kompetencë e Bordit.

**Mejdi Rexhepi**

Kryetar  
Federata e Tenisit e Kosovës



Prishtinë, 13 dhjetor 2018